

VENDIM
Nr.829, datë 28.7.2010

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES
TE MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT,
TË PRONËS “QENDËR REKRUTIM- MOBILIZIMI”, NË ELBASAN, DHE KALIMIN
NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, TE MINISTRIA E MBROJTJES, TË
PRONËS “LABORATOR USHQIMI”, NË ELBASAN, SI DHE PËR DISA NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI
MINISTRISË SË MBROJTJES”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të pronës nr.285 “Qendër rekrutim-mobilizimi”, në Elbasan.

2. Kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, te Ministria e Mbrojtjes, të pronës “Laborator ushqimi”, me vendndodhje në zonën kadastrale nr.8525 në Elbasan, me sipërfaqe 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m².

3. Prona nr.285 me emërtesë “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në Elbasan, me sipërfaqe 710 (shtatëqind e dhjetë) m², të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, dhe të marrë emërtimin “Laborator ushqimi”. Prona të jetë në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në inventarin me nr.17 të kësaj ministrie.

4. Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

5. Prona me emërtesë “Laborator ushqimi”, në zonën kadastrale nr.8525 me sipërfaqe 133 (njëqind e tridhjetë e tre) m², në Elbasan, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, dhe të marrë numërtimin prona nr.285, me emërtimin “Qendër rekrutim- mobilizimi”, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

6. Ministrisë së Mbrojtjes i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t’ua japë në përdorim të tretëve.

7. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe kryerregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha